



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr.244, datë 29.10.2019**

**PËR  
REFUZIMIN E CAKTIMIT TË GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE  
GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO  
KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar, në kërkesat e Kryetarit në detyrë (Zëvendëskryetarit) të Gjykatës së Apelit Shkodër për caktim gjyqtarësh për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta në këtë gjykatë, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, në përfundim,

**VENDOSI:**

1. Refuzimin e kërkesës së Kryetarit në detyrë (Zëvendëskryetarit) të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e 2 (dy) gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë (çështja penale nr.288, datë 04.09.2019 me palë kërkuese: z. {...}; me objekt: pushim gjykimi), në kushtet e mosevidentimit të “nevojës” në kuptim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

2. Refuzimin e kërkesës së Kryetarit në detyrë (Zëvendëskryetarit) të Gjykatës së Apelit Shkodër, për caktimin e 1 (një) gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë (çështja penale nr.285, datë 30.08.2019 me palë kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; të pandehur: z. {...}, z. {...}; me objekt: pushim gjykimi), në kushtet e mosevidentimit të “nevojës” në kuptim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

